



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKT LIGJ

Nr _____ / 2014

PËR

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9975,
DATË 28.7.2008, “PËR TAKSAT KOMBËTARE”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Në ligjin nr.9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 3, “Llojet e taksave kombëtare”, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Pika 2 dhe pika 6 ndryshohen në:

“2. Taksa e qarkullimit për benzinën (sipas kodeve tarifore të NKM-së 2710 12 41; 2710 12 45; 2710 12 49; 2710 12 51; 2710 12 59) dhe për gazoilin (sipas kodeve tarifore të NKM-së 2710 19 31; 2710 19 35 ; 2710 19 43 ; 2710 19 46 ; 2710 19 47; 2710 19 48).

6. Taksa e karbonit për benzinën (sipas kodeve të NKM-së 2710 12 41; 2710 12 45; 2710 12 49; 2710 12 51; 2710 12 59), për gazoilin (sipas kodeve të NKM-së 2710 19 31; 2710 19 35; 2710 19 43; 2710 19 46; 2710 19 47; 2710 19 48), për qymyrin (sipas krerëve të NKM-së

2701; 2702), për vajgurin (sipas kodeve tarifore të NKM-së 27 10 19 11 deri 27 10 19 29), për solarin (sipas kodeve të NKM-së 2710 19 62 deri 2710 19 68), për mazutin (sipas kodeve të NKM-së 2710 19 62 deri 2710 19 68) dhe për koks nafte (sipas kodeve të NKM-së 2713 11 00; 2713 12 00).”.

2. Pas pikës 9 shtohet pika 10, me këtë përmbajtje:

“10. Taksa mbi primet e shkruara, me përjashtim të primeve të sigurimit për produktet e jetës, shëndetit në udhëtim dhe kartonit jeshil.”

Neni 2

Në nenin 4, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Pika 2 ndryshon dhe bëhet si vijon:

“2. Taksa e qarkullimit mbi benzinën dhe gazoilin caktohet në masën 27 lekë/litër për benzinën dhe 27 lekë/litër për gazoilin.”

2. Në paragrafin e parë, të pikës 4, bëhen këto ndryshime:

- a) Pas fjalisë së parë, shtohet fjalia me këtë përmbajtje: “Përqindja e rentës minerare për përmbajtjen e mineralit krom në nënproduktin mineralar është në masën sa 2/3 e normës së rentës të përcaktuar në shtojcën nr.2, që i bashkëlidhet këtij ligji.”
- b) Fjalia e fundit ndryshon me këtë përmbajtje: “5 (pesë) përqind e të ardhurave nga renta minerare i takojnë pushtetit vendor ku zhvillohet veprimtaria. Të ardhurat nga renta minerare përdoren për investime për njësitë e qeverisjes vendore.”.

3. Pas pikës 8 shtohet pika 9, me këtë përmbajtje:

“9. Taksa mbi primet e shkruara, me përjashtim të primeve të sigurimit për produktet e jetës, shëndetit në udhëtim dhe kartonit jeshil, është 3 (tre) përqind e shumës së primit.”

Neni 3

Në nenin 5, pas shkronjës “f”, shtohet shkronja “g”, me këtë përmbajtje:

“g) Shoqëritë e sigurimit të licencuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) ngarkohen me mbledhjen e taksës mbi primet e shkruara.”.

Neni 4

Pas shkronjës “ë”, të pikës 2, të nenit 8, shtohet shkronja “f”, me këtë përmbajtje:

“f) për taksën mbi primet e shkruara, zero përqind”.

Neni 5

Në nenin 9 bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

1. Shkronja “b”, e pikës 1, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“b) Personat fizikë apo juridikë, të cilët deklarojnë se nuk do të qarkullojnë me mjete në pronësi të tyre gjatë vitit kalendarik, përkohësisht vetëm njëherë brenda një viti kalendarik, ose do të dalin përfundimisht nga qarkullimi dhe që dorëzojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor, targën dhe lejen e qarkullimit, me kusht që të kenë paguar detyrime të prapambetura, nëse kanë.”

2. Në fund të shkronjës “c”, të pikës 1, shtohen fjalët:

“... dhe pagesat e taksës së mjeteve të vërtetuara si të vjedhuara nga organet e prokurorisë.”.

3. Pika 2 shfuqizohet.

4. Numërtimi i pikës 4, bëhet pika 5.

5. Pas pikës 5 shtohet pika 6, me këtë përmbajtje:

“6. Përfshihen nga pagimi i taksës së qarkullimit dhe taksës së karbonit anijet e peshkimit. Sasitë, kushtet dhe kriteret përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Neni 6

Ky ligj botohet në “Fletoren zyrtare” dhe hyn në fuqi në 1 janar 2015.

K R Y E T A R I

ILIR META

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9975, DATË 28.7.2008, “PËR TAKSAT KOMBËTARE”, TË NDRYSHUAR

I. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Përgatitja e projektligjit “ Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar është mbështetur në nenet 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës.

Ky projektligj është pjesë e Paketës Fiskale 2015.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj është në përputhje me programin politik të qeverisë dhe synon:

- ✓ zhvillimin e sektorit të peshkimit, duke ulur kostot e karburantit që përbëjnë rreth 80% të kostove totale të anijeve të peshkimit;
- ✓ rritjen e investimeve në infrastrukturën rrugore nëpërmjet rritjes së financimeve përmes taksimit të karburanteve;
- ✓ rritjen e decentralizimit fiskal të pushtetit vendor me transferimin e më shumë të ardhurave nga renta minerare;
- ✓ mbështetjen e sektorit të sigurimeve.

Projektligji është i parashikuar në programin analitik të projektligjeve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë 4 mujorit të III të vitit 2014.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTLIGJIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ky projektligj është pjesë e Paketës Fiskale 2015 dhe gërsheton një sërë propozimesh që prekin fusha të ndryshme të taksave kombëtare.

Projektligji synon të zgjidhë përfundimisht çështjen e “ndarjes së taksës së rentës minerare” midis pushtetit vendor dhe pushtetit qendror, shtimin e lehtësive fiskale në sektorin e peshkimit, për të rritur incentivat dhe formalizimin e këtij sektori, mbështetjen e sektorit të sigurimeve, duke e trajtuar fiskalisht sipas eksperiencave evropiane; rishikimin në rritje të taksës së qarkullimit, në kuadër të politikave të mbrojtjes së mjedisit dhe rritjen e investimeve në infrastrukturën rrugore.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është mbështetur në nenet 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKT-AKTET NORMATIVE)

Projektligji nuk synon përafrimin me legjislacionin komunitar.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKT-AKTIT

Neni 1, i projektligjit, propozon disa ndryshime:

- a) Propozohet një rregullim teknik, përsa i përket Kodeve të Nomenklaturës së Kombëtare të Mallrave lidhur me produktet e gazoil, benzines, mazutit, vajgurit, solarit dhe koksit të naftës;
- b) Vendos një taksë të re kombëtare, taksa mbi primet e shkruara, me përjashtim të primeve të sigurimit për produktet e jetës, shëndetit në udhëtim dhe kartonit jeshil.

Reformimi i sektorit të sigurimeve ka qenë një nga prioritetet e qeverisë gjatë vitit 2014, me synim uljen e kostove dhe barrierave fiskale apo administrative dhe dhënien e një frymëmarrjeje më të gjerë. Viti 2015 do të materializojë mbështetjen e qeverisë ndaj sektorit të sigurimeve, një sektor jetik për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit. Vlen për të theksuar se nga data 1 janar 2015, do të zbatohet përjashtimi nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar i primeve të shkruara për produktet e jo-jetës, (duke sjellë trajtimin e tyre fiskal sipas direktivës evropiane), masë kjo me një efekt 500 milionë lekë minus nga të ardhurat nga TVSH-ja, ndërsa vendoset një taksë e re kombëtare, prej 3% mbi to. Efekti në të ardhurat e buxhetit të shtetit për vitin 2015 do të jetë rreth 220 milionë lekë. Efekti neto në të ardhurat nga këto dy taksa do të jetë negativ, me rreth 280 milionë lekë, por vlerësohet që këto ndryshime të jenë faktor nxitës për shtimin e aktivitetit, thelbësisht të përmirësuar, të shërbimit të sigurimeve, që ende vuan nga standarde të ulëta, krahasuar me BE-në dhe fqinjët.

Këto propozime fiskale janë bërë në partneritet dhe bashkëpunim me Shoqatën e Siguruesve të Shqipërisë lidhur me nivelet e taksimit të primeve të shkruara, pas një konsultimi të gjatë me eksperiencat rajonale, evropiane dhe specifike kombëtare. Ky treg aktualisht ka këtë trajtim mbi primet:

1. Tregu i sigurimeve paguan si detyrim ligjor 1.5% të totalit të primeve për AMF-në.
2. Tregu i sigurimeve paguan, në bazë të një memorandumit (të propozuar) bashkëpunimi me Ministrinë e Brendshme dhe atë të Transportit, 3% në vit të totalit të primeve të sigurimit të detyrueshem motorrik, në funksion të jetësimit të masave të qeverisë për rritjen e sigurisë rrugore.

Eksperiencat krahasuese të vendeve evropiane e kanë aplikuar shumë vonë mbi tregun e sigurimeve këtë taksë dhe mesatarja e tyre varion nga 1,7% (Qipro) - 6,5% (Anglia), të cilat janë tregje që në raport me volumin e primeve janë të pakrahasueshëm me tregun shqiptar (0,64% i PBB-së). Bullgaria, me një treg sigurimesh me xhiro vjetore prej një miliard euro, ka nivelin e taksimit mbi primet e sigurimeve, në masën 2%. Anglia me një eksperiencë disa shekullore në sigurime, e ka vendosur këtë taksë mbi produktet e sigurimit vetëm në vitin 2005 dhe Zvicra, nivelin e kësaj takse e ka në masën 5 %.

Referuar të dhënave të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF), rezulton se për vitin 2013, totali i primeve të shkruara është 7.5 miliardë lekë, pa përfshirë këtu primet për produktet e jetës, shëndetit në udhëtim dhe kartonit jeshil. Efekti në të ardhurat e buxhetit të shtetit për vitin 2015 do të jetë rreth 220 milionë lekë.

Neni 2, i projektligjit propozon disa ndryshime lidhur me taksën e qarkullimit, taksën vjetore të mjeteve të përdorura të transportit dhe të rentës minerare.

Taksa e qarkullimit

Kostot e mirëmbajtjes së infrastrukturës së rrugëve dhe efektet që shkakton përdorimi i karburanteve në mjedis kanë ardhur në rritje. Për pasojë, vjen e nevojshme gjetja e mënyrave të drejtpërdrejta apo të tërthorta për të përballuar këto kosto. Një nga këto mënyra është edhe rritja e taksës së qarkullimit. Me këtë projektligj propozohet një rritje me 10 lekë/litri të taksës së qarkullimit nga 17 lekë/litër në 27 lekë/litër.

Arsyet për ndryshimin e kësaj takse janë:

- **nevojat në rritje të mirëmbajtjes së infrastrukturës rrugore.** Taksat gjithsej në benzinë dhe naftë janë 57 lekë/litër. Totali i mbledhjes së këtyre taksave, ekonomikisht, nuk mbulon plotësisht investimet me anë të buxhetit të shtetit. Kjo rritje e taksës lidhet në mënyrë të drejtëpërdrejtë dhe me shpenzimet buxhetore të parashikuara për vitin 2015 për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës ku është parashikuar rritje e fondeve buxhetore me qëllim parësor uljen e aksidenteve duke investuar në përmirësimin e sinjalistikës dhe mirëmbajtjen rrugore.

- **adresimi i efekteve anësore** në lidhje me mjedisin, duke vazhduar angazhimet ambientaliste të qeverisë;
- marrja në konsideratë e **një game efektesh anësore**, nga përdorimi i mjeteve rrugore, të cilat duhet të reflektohen në taksat e karburantit motorik (përfshirjen e emetimeve të karbonit, ndotjen e ajrit lokal, bllokimet dhe aksidentet).

Duhet theksuar se me gjithë propozimet e mësipërme, Shqipëria ende nuk i plotëson kërkesat minimale të BE-së për akcizat e karburanteve motorike. Direktiva e BE-së 2003/96 kërkon një akcizë minimale prej 0,359 euro (50 lekë) për litër për benzinën, 0.330 euro (46 lekë) për litër në naftën (motorike). Përsa i përket ndikimit të rritjes së kësaj takse në çmimin final të shitjes me pakicë të naftës dhe benzinës, vlerësohet se kjo rritje takse nuk do të përkthehet në rritje çmimi, për arsye të rënies së çmimeve në tregjet ndërkombëtare. E njëjta rritje takse u bë edhe në Paketën Fiskale 2014, rritje e cila nuk u pasqyrua në rritjen e çmimit në tregun e brendshëm.

Efekti në të ardhurat e buxhetit të shtetit vlerësohet të jetë rreth 5.6 miliardë lekë nga taksa e qarkullimit dhe 1.1 miliardë lekë nga TVSH-ja, për vitin 2015.

Renta minerare

Në pikën 4, të nenit 2, të projektligjit, propozohet që përqindja e rentës minerare për përmbajtjen e mineralit krom në nënproduktin mineralar të jetë në masën sa 2/3 e normës së rentës të përcaktuar në shtojcën nr.2, të ligjit.

Ky propozim, i cili vjen nga grupet e interesit, ka për qëllim nxitjen e investimeve direkte vendase dhe të huaja nëpërmjet rritjes së shkallës së përpunimit të këtij minerali në vend.

Në adresim të kërkesës së Shoqatës së Mineraleve të Shqipërisë për uljen e rentës minerale për mineralin e kromit të përpunuar në vend, dhe me qëllim nxitjen e investimeve direkte vendase dhe të huaja, nëpërmjet rritjes së shkallës së përpunimit të këtij minerali në vend, është propozuar që përqindja e rentës minerare për përmbajtjen e mineralit krom në nënproduktin mineralar të jetë në

masën sa 2/3 e normës së rentës së mineralit. Aktualisht, struktura e eksportit të kromit mbizotërohet nga minerali i papërpunuar, ku pesha specifike e mineralit të papërpunuar të kromit zë rreth 91% (koncentrati i kromit dhe ferrokromi zënë në total rreth 9%).

Rritja e shkallës së përpunimit të këtij minerali në vend, që vjen si pasojë e uljes së masës me 1/3 e normës së rentës, pritet të sjellë rritjen e të ardhurave të arkëtueshme nga renta minerare. Megjithë efektet negative që do të sjellë kjo masë në të ardhurat nga renta në masën 45.3 milionë lekë, efektet pozitive të pritshme nga ulja e rentës minerare të nënprodukteve të kromit janë më të larta në drejtim të inkurajimit të investimeve në industri përpunuese; rritjes së furnizimit me lëndë të parë në vend, kundrejt eksportit, rritjes së investimeve kapitale në vend apo stimullit të vendeve të reja të punës

Duke iu referuar të dhënave të vitit 2013, ku arkëtimet nga renta minerare për koncentratin e kromit dhe ferrokromit ishin rreth 136 milionë lekë, efekti në të ardhurat e buxhetit të shtetit për vitin 2015 vlerësohet të jetë afërsisht minus 45.3 milionë lekë.

Në nenin ,2 të projektligjit, propozohet që të ndryshojë përqindja e të ardhurave nga renta minerare që merr pushteti vendor ku zhvillohet veprimtaria minerare, nga 25% në 5%. Ky ndryshim ligjor shoqërohet dhe siguron përputhshmëri edhe me projektligjin që do të miratojë buxhetin e shtetit 2015, sipas të cilit marrja e rentës minerare nga pushteti vendor nuk do të jetë më e lidhur me shumën e transfertës së pakushtëzuar.

Si rrjedhojë e ndryshimeve në këto dy ligje, bazuar në të ardhurat nga renta minerale për vitin 2013, të cilat vlerësohen rreth 7.8 miliardë lekë për vitin 2015, pushtetit vendor do t'i kalojnë rreth 400 milionë lekë nga 100 milionë lekë, që bashkitë dhe komunat kanë marrë në vitin 2013.

Ndarja e të ardhurave nga renta minerare midis pushtetit vendore dhe qendror përbën një politikë normale fiskale të decentralizimit fiskal. Mirëpo, për këtë ndarje të ardhurash midis dy pushteteve, ka dy ligje specifike të cilat përcaktojnë

procedurën e shpërndarjes dhe që në dualizëm me njëra-tjetrën kanë bërë që, “de facto”, shumë pak rentë të marrë pushteti vendor.

Në bazë të ligjit të taksave kombëtare, 25% e të ardhurave nga renta minerale i jepet bashkive dhe komunave. Por bashkitë dhe komunat nuk marrin, sipas këtij ligji, 25% të të ardhurave nga renta, sepse në ligjin e buxhetit të shtetit është kufizuar marrja e kësaj rente nga bashkitë dhe komunat, duke e lidhur me shumën e transfertës së pakushtëzuar.

Ndërkohë, në nenin 15, të ligjit nr.10487, datë 5.12.2011, “Për buxhetin e vitit 2012”, pjesa e të ardhurave nga renta minerare që u takon njësive të qeverisjes vendore shpërndahet nga Ministria e Financave, sipas kërkesave të njësive të qeverisjes vendore, në përputhje me procedurat ligjore dhe formulës së përcaktuar në këtë ligj.

Në nenin 3 dhe 4, të projektligjit propozohet që shoqëritë e sigurimit të licencuara nga AMF-ja të jenë agjentë tatimorë për taksën mbi primet e shkruara dhe komisioni për to propozohet në masën zero përqind.

Në nenin 5, të projektligjit, propozohen disa ndryshime të cilat adresojnë problematika të dala nga zbatimi në praktikë.

a) Shkronja “b”, e pikës 1, të nenit 9, të ligjit, parashikon që, një person fizik ose juridik për të nxjerrë nga qarkullimi një automjet në pronësi të tij, mund ta bëjë këtë gjë vetëm brenda muajit janar të çdo viti, përndryshe, duhet të paguajë taksën e plotë vjetore të mjeteve të përdorura. Ky përcaktim i kërkon tatimpaguesit që të parashikojë që në muajin janar nëse do ta nxjerrë mjetin nga qarkullimi apo jo, pavarësisht se pagesën e taksës vjetore të mjeteve të përdorura e ka paguar, p.sh. në muajin qershor, dhe mund të zgjedhë që ta nxjerrë mjetin nga qarkullimi pasi t’i mbarojë afati për pagesën e taksës vjetore të mjeteve të përdorura. Ndryshimi i propozuar në projektligj synon që individi të bëjë çrregjistrimin e mjetit në cilindo moment që ai vendos ta bëjë këtë.

b) Në bazë të ligjit nr.9975/2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, shkronja “c”, e nenit 9, parashikon se përjashtohen nga pagimi i taksës vjetore të mjeteve të

përdorura mjetet e bllokuara me vendim gjykatë, prokurorie, etj, për periudhën në të cilën mjeti ka qenë i bllokuar. Ndërkohë, ligji nuk parashikon, në asnjë rast, se si do të procedohet për çrregjistrimin e mjetit që deklarohet i vjedhur në organet e prokurorisë. Mos parashikimi i këtij rasti sjell që subjekti tatimpagues, pronari i makinës, të paguajë taksën vjetore të mjeteve të përdorura duke mos e poseduar realisht një makinë.

c) Pika 2, e nenit 9, shfuqizohet, për arsye se ka ngelur pa funksion, pasi ka të bëjë me ndryshimet e bëra me ligjin nr.10280, datë 20.5.2010, kur filloi të zbatohet taksa e mjeteve të përdorura në shitje. Aktualisht, nuk aplikohet as në import dhe as në shitje, taksë mbi makinat e përdorura.

d) Pas pikës 4, të nenit 9, shtohet pika 5, e cila parashikon përjashtimin nga taksa e qarkullimit dhe taksa e karbonit të anijeve të peshkimit. Sasitë, kushtet dhe kriteret për zbatimin e këtij përjashtimi do të përcakohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Bazuar në faktin se ky sektor, me ligj, është i përjashtuar nga pagesa e akcizës prej 37 lekë/litri, përjashtimi nga taksa e qarkullimit dhe karbonit prej 30 lekë/litri, do të çonte në një total të masës së përjashtimit prej 67 lekë/litri.

Përjashtimi nga këto taksa për anijet e peshkimit synon rritjen e volumit të transaksioneve të biznesit vendas, formalizimin e shitjeve dhe reflektimin real në PBB-në e vendit; rritjen e të ardhurave në buxhet si dhe rritje dhe reflektim real i të punësuarve në këtë sektor; uljen e kostove për sektorin, pasi për shkak të kostos së lartë, krahasuar me vendet fqinje, furnizimi i karburantit bëhet të paktën 1 herë në muaj, në këto vende; si dhe përmirësimin e barazisë në treg ndërmjet operatorëve në kushtet e një formaliteti më të lartë.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E KËTIJ AKTI

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKT-AKTIT

Projektligji është hartuar nga Ministria e Financave.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj ka impakt pozitiv në të ardhurat e buxhetit të shtetit, në zërin “Të ardhura nga taksa nacionale dhe të tjera”, në shumën 6.475 miliardë lekë, të cilat janë parashikuar në buxhetin e shtetit për vitin 2015.

KËSHILLI I MINISTRAVE